

20140270929

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR VEPRIMTARI TURISTIKE

Neni 1

Në Ligjin për veprimtari turistike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/2004, 89/2008, 12/2009, 17/11, 47/11, 53/11, 123/12 dhe 164/13), pas nenit 8 shtohet nen i ri 8-a, si vijon:

"Neni 8-a

Agjencia turistike që drejtpërdrejt i ofrojnë shërbime udhëtarit nëpërmjet mjeteve për komunikim elektronik janë të obliguar të punojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat nga fusha e tregtisë elektronike."

Neni 2

Në nenin 37 pas paragrafit 2 shtohen tre paragrafë të rinj 3, 4 dhe 5, si vijojnë:

"Agjencia turistike-ndërmjetës me licencë B që i ofron shitje dhe i shet udhëtim turistik organizatorit të udhëtimit, është e obliguar në programin e udhëtimit dhe vërtetimin për udhëtim ta shënojë cilësinë në të cilën paraqitet, numrin e licencës së organizatorit të udhëtimit dhe udhëtarit t'ia dorëzojë drejtpërdrejt ose në formë elektronike, njëkohësisht me dhënien e vërtetimit për udhëtim, programit dhe kushteve të përgjithshme të udhëtimit të organizatorit të udhëtimit.

Agjencia turistike – ndërmjetës ofron dhe shet vetëm udhëtime turistike organizatorëve të udhëtimeve, me të cilët ka lidhur marrëveshje për ndërmjetësim.

Agjencia turistike – ndërmjetës është e obliguar të ofrojë dhe shesë aranzhmane turistike në kushte të njëjta, si edhe organizatori i udhëtimeve."

Neni 3

Në nenin 39 paragrafi 2 fjalët: "mal dhe" shlyhen.

Pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3, si vijon:

"Udhërrëfyesit në mal të cilët udhëheqin grupe turistike duhet të kenë certifikatë të lëshuar nga asociacioni që në Republikën e Maqedonisë është i akredituar për lëshim të certifikatës për udhërrëfyes ndërkombëtarë në mal."

Neni 4

Në nenin 44 pas paragrafit 1 shtohet paragraf i 2, si vijon:

"Udhërrëfyesi turistik gjatë ofrimit të shërbimit doemos duhet në vend të dukshëm ta mbajë legjitimacionin e udhërrëfyesit turistik me të cilin vërtetohet cilësia e tij."

Paragrafët 2 dhe 3 bëhen paragrafë 3 dhe 4.

Në paragrafin 4 që bëhet paragraf 5 numri "3" zëvendësohet me numrin "4".

Paragrafi 5 bëhet paragraf 6.

Pas paragrafit 6 shtohet paragraf i ri 7, si vijon:

"Legjitimacioni i udhërrëfyesit turistik kufizohet në dhjetë vite me të drejtë që të parashtrijë kërkesë për marrje të legjitimacionit të ri."

Neni 5

Në nenin 48 pas paragrafit 1 shtohet paragrafi 2, si vijon:

"Shoqëruesi turistik gjatë ofrimit të shërbimit doemos duhet në vend të dukshëm ta mbajë legjitimacionin e shoqëruesit turistik me të cilin vërtetohet cilësia e tij."

Paragrafët 2 dhe 3 bëhen paragrafë 3 dhe 4.

Në paragrafin 4 që bëhet paragraf 5 numri "3" zëvendësohet me numrin "4".

Paragrafi 5 bëhet paragraf 6.

Pas paragrafit 6 shtohet paragraf i ri 7 si vijon:

”Legjitimacioni i shoqëruesit turistik kufizohet në dhjetë vite me të drejtë që të parashtojë kërkesë për marrje të legjitimacionit të ri.”

Neni 6

Pas nenit 48-a shtohen katër nene të reja 48-b, 48-v, 48-g dhe 48-d, si vijojnë:

“Neni 48-b

Udhërrëfyesi turistik dhe shoqëruesi turistik është i obliguar të ofrojë shërbime të udhërrëfyesit turistik/ shoqëruesit turistik, në mënyrë të ndërgjegjshme dhe profesionale në pajtim me dispozitat e këtij ligji, rregullat e miratuara në bazë të tij, zakonet e mira afariste në turizëm, statutin dhe aktet e shoqatës së udhërrëfyesve dhe shoqëruesve turistikë, nëse është anëtar i tyre.

Agjencia turistike është e obliguar për kryerjen e veprimtarisë udhërrëfyes/shoqërues turistik të angazhojë person i cili ka legjitimacion për udhërrëfyes/shoqërues turistik, në pajtim me të cilin e kryen veprimtarinë.

Neni 48-v

Agjencia turistike është e obliguar të mbajë evidencë për udhërrëfyesit turistikë të cilët i angazhon.

Për udhërrëfyesit e angazhuar turistikë, agjencia turistike parashtron raport te organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e turizmit, si dhe te personi i autorizuar juridik për lëshimin e legjitimacioneve për udhërrëfyes turistikë me të dhënat në vijim:

- emrin, mbiemri, dhe NUA të udhërrëfyesit turistik,
- lokalitetin turistik në të cilin ka qenë i angazhuar dhe
- kohën, periudhën e angazhimit.

Raporti nga paragrafi 2 i këtij parashtrohet më së voni deri më 31 janar në vitin rrjedhës për vitin paraprak.

Neni 48-g

Legjitimacioni për punë të udhërrëfyesit turistik dhe shoqëruesit turistik shfuqizohet:

- me kërkesë të udhërrëfyesit turistik ose shoqëruesit turistik, ose
- me heqje të legjitimacionit për udhërrëfyes turistik ose shoqërues turistik.

Neni 48-d

Legjitimacioni për punë të udhërrëfyesit turistik dhe shoqëruesit turistik do të hiqet nëse:

- është e bazuar në të dhëna të pavërteta, ose dokumente të falsifikuara ose
- nëse udhërrëfyesi turistik nuk ofron shërbime në pajtim me nenin 48-b të këtij ligji.

Personi juridik nga neni 44 paragrafi 4 të këtij ligji, miraton aktvendim për ndërprerje, përkatësisht heqje të legjitimacionit për udhërrëfyes turistik/shoqërues turistik.

Procedurën për heqje të legjitimacionit të udhërrëfyesit turistik dhe shoqëruesit turistik më afërsisht e përcakton personi juridik nga neni 44 paragrafi 4 i këtij ligji.

Ndërprerja, përkatësisht heqja e legjitimacionit të udhërrëfyesit turistik dhe shoqëruesit turistik regjistrohet në Regjistrin e udhërrëfyesve dhe shoqëruesve turistikë."

Neni 7

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për veprimtari turistike.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".